

Dr. Qufli Osmani është psikolog dhe ligjërues universitar me përvojë të gjerë akademike dhe profesionale në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe vlerësim psikometrik. Aktualisht punon si ligjërues në UBT në Prishtinë, ku mban lëndët e Psikologjisë së Shëndetit ,Psikometri,Statistikë dhe Psikologjisë Forenzike në nivelin bachelor dhe master. Gjatë karrierës së tij, ai ka kontribuar në disa institucione të arsimit të lartë, përfshirë UPZ – Prizren dhe Kolegjin Fama, ku ka shërbyer edhe si Dekan.

Dr. Osmani ka bashkëpunuar me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, si dhe me organizata ndërkombëtare, në zhvillimin e programeve edukative dhe vlerësimeve psikometrike. Ai ka përfunduar studimet e doktoratës, masterit dhe bachelorit në Psikologji në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup. Është autor i disa teksteve universitare dhe publikimeve shkencore, dhe ka marrë pjesë në konferenca rajonale dhe ndërkombëtare. Me aftësi të forta teknike dhe analitike, shumëgjuhësi dhe përvojë të gjerë në psikologjinë akademike dhe të aplikuar, ai vazhdon të kontribuojë në kërkim, mësimdhënie dhe zhvillim edukativ.